



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0035257/25 dt. 18.06.25
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 14 dhe 31 paragrafi 2.6, të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe pas shqyrtimit të Propozim-Vendimit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-020/04-0035257/25, dt. 18.06.2025, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-020/04-0035257/25, dt. 18.06.2025, dhe i lejohet shpallja e Thirrjes Publike për Subvencionimin e fermerëve sipas projektit “Furnizimi dhe Montimi i Serrave të tipit Tunel, me sipërfaqe prej 50 m² me material përcjellës”, si dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, në shumë prej 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro), me qëllim të realizimit të këtij projekti sipas Planit të Punës së kësaj Drejtorie për vitin 2025.
2. Drejtoria për Bujqësi dhe zhvillim Rural obligohet që ti zhvillojë procedurat konform kriterëve dhe dispozitave të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
3. Thirrja Publike për realizimin e këtij projekti e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi, së bashku me kriteret do të publikohen në web faqen e Komunës, dhe e njëjta do të qëndrojë e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i publikimit.
4. Në përputhje me Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe me propozimin e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës do të formojë Komisionin Vlerësues i cili do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara me Thirrjen Publike.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ndërsa mjetet e parapara sipas këtij Vendimi paguhen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
6. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është e obliguar të njoftojë përfituesit për kohën dhe datën e nënshkrimit të Kontratave.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-020/04-0035257/25, dt. 18.06.2025;
Thirrja Publike e DBZHR-së.

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Arkivit